



Prishtinë: 03.11.2009

Kodi i ZRRE-së: V_211_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_284_09_09

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_284_09_09;
5. Apelimi i konsumatorit i datës 07.10.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2009 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Refik Sadiku (shifra e konsumatorit në KEK: **DPR – 33271**) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetimi

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK- së në ZRRE me datë 28.08.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 31.07.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 12.02.2009 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut për ndërrimin e njehsorëve elektrik me kërkesën e konsumatorit të datës 09.02.2009 kanë vizituar objektin e konsumatorit dhe kanë konstatuar se konsumatori ka larguar nga matja e konsumit të energjisë elektrike njehsorin elektrik me nr. 30202398, dhe kanë vendosur për matje të konsumit njehsorin elektrik me nr. 91338885.
Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 008333
- Me datë 25.04.2009 zyrtarët e autorizuar për kontrollimin e njehsorëve elektrik në qendrën e Kalibrimit, kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik me nr. 30202398, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat shtetërore i ka të manipuluar, numëruesi i njehsorit është i manipuluar si dhe rreth qelqit nga të dy anët është futur shirit filmi.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 06/25 të datës 25.04.2009
- Me datë 22.05.2009 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë vizituar objektin e konsumatorit për të bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 337045 të datës 22.05.2009

- Me datë 25.06.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike me anë të faturës DPR09HP07830 në vlerë prej 931.67 €
Provë: Fatura DPR09HP07830 e datës 25.06.2009
- Me datë 08.07.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 31.07.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 31.07.2009
- Me datë 28.08.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 29.09.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar ankesën e konsumatorit lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 29.09.2009
- Me datë 07.10.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_284_09_09.
Provë: Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_284_09_09** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së.

Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar